



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROÇESVERBAL

Nr. 12, datë 27.07.2023

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 27.07.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin korrik.

Siç jeni vënë në dijeni për rendin e ditës nga Sekretaria e Këshillit nëpërmjet postës elektronike, në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Ardian Muka ... Prezent.....deri tek.... Florian Tahiri...Prezent.

Kryetar ke 42 këshilltar në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Sot për shqyrtim e miratim kemi 13 pika.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN KORRIK 2023
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR. 17, DATË 18.01.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/27, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP.19367.4 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/31, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP.609.42 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/33, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP. 2125.51 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/168, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP. 7518.84 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/162, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 2946.04 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/159, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 7105.83 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/34, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP. 1703.31 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/32, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 24827.4 M ² ; NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRRETH KOMPLESIT TË STADIUMIT “NIKO DOVANA” NË DURRËS, PËRFSHIRË STADIUMIN, E LIDHUR MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË DURRËS, AGJENCISË SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH)
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.101, DATË 29.9.2022, “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T’U DREJTUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM TË VKM-SË NR. 431, DATË 15.05.2013, DHE MIRATIMIN E PËRDITËSIMIT PJESOR TË PRONËS ME EMËRTIMIN “FUSHË SPORTI”, ME VENDODHJE KATUND I RI, ZK 2117
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE DHE NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 67, DATË 17.03.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, RRUGA “DOKTOR SPIRO TRESKA”, PALLATI NR. 19, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”.
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 49, DATË 31.05.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA

Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 2, RRUGA “ISUF MOLLA”, PALLATI NR. 27, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.”
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71, DATË 12.07.2022, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATI NR.8, RRUGA “TELAT NOGA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 36, DATË 09.05.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL, PALLATI NR. 39, RRUGA “GJON KASTRIOTI”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË BASHKISË DURRËS
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 49, DATË 31.05.2022, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.2, PALLATIN NR.21, RRUGA “ISUF MOLLA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 67, DATË 17.03.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATIN NR.19, RRUGA “DOKTOR SPIRO TRESKA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË PRONËS ME NUMËR LISTE TË TRANSFERIMIT 258, ME EMËRTIM “VENDSTREHIM”, ME VENDODHJE PRANË SHKOLLËS SË MESME “GJERGJ KASTRIOTI”, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TE BASHKISË DURRËS
Pika 12. Shqyrtim dhe miratim i	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, TË PRONËS SË PALUAJTSHME ME NUMËR PASURIE 36, ZK 8517; NR. 37, ZK 8517, NR. 338/2, ZK 8517, DHE NR. 338/1, ZK 8517, QË DO

projektvendimit	TË PËRDORËN NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE, DHE PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE APO SHËRBIMEVE TË TJERA NË FUNKSION TË BASHKISË
Pika 13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 18, DATË 31.01.2023, PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTOROMANOS - KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË”

Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 42 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit znj.Edlira Shemsi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit pasi shqyrtoi pikën 1 të rendit të ditës për kalimin e ndihmës ekonomike për mujajin korrik 2023 e miratoi atë duke patur kuorumin e nevojshëm dhe ia kalon për miratim këshillit .

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Shemsi.

Përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Dritan Burgija : Desha të bëja unë një koment.

Ani Dyrmishi : Po.

Dritan Burgija : Në relacionin që keni paraqitur këtu kanë paraqit kërkesën e tyre 1109 familje për tu trajtuar me pagesë për ndihmë ekonomike. Përfitues janë 108 familje është dhe fondi këtu. Do bëj një koment. Referuar indeksit të Raportit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2021 referon se varfëria në Shqipëri mbetet e lartë me 23.3%. Sipas INSTAT-it vlerësohet se niveli i përjashtimit social në Shqipëri, pra individëve në rrezik varfërie ose thellësisht të privuar materialisht ose me intesitet shumë të ulët në punësim është rreth 46.2 % e popullsisë. Pra, gjysma e popullsisë janë nën nivelin minimal. E kuptoj atë 6 %-shin që keni Ju në dispozicion, por mendoj se duhet të sforcohem më shumë që të ndihmojmë sa më shumë familje në nevojë. Ne do t'i shkojmë traditës që gjithmonë do votojmë ndihmën ekonomike dhe do japim votën pro, por do të doja që të gjithë bashkë punojmë më shumë në këtë drejtim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Po znj. Shemsi.

Edlira Shemsi : Në komisionin tonë ishte dhe shefja e Drejtorisë Sociale të bashkisë. Ne kërkuam një listë të gjithë personave që kanë kërkuar asistencë, atë që tha z. Burgija, ç'ka u tha që sigurisht do miratohet sot. Ne kërkuam dhe për invalidët që marin asistencë pranë bashkisë. Nuk e përmenda pak më parë ndoshta do e diskutojmë njëherë tjetër. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Shemsi.

Koment tjetër nga ana këshilltarëve ka?

Dritan Burgija : Do kujtoja këtu projektligjin që ka çu Partia Demokratike, Partia ime Demokratike në korrik për minimumin jetik. Nuk u realizua se sigurisht prioritet aty ishin pagat e deputetëve, kjo është filozofia. Filozofi që e shpalosi dhe një nga kolegët në komision të buxhetit.

Ani Dyrmishi : Dritan këtu duhet të ndërpres, mos kalojmë në debate pa lidhje.

Dritan Burgija : Një sekond se jemi dhe përfaqësues politik këtu.

Ani Dyrmishi : Përfaqësues politik, por ka rend dite.

Dritan Burgija : Do bëj një koment, kur një nga kolegët tuaj propozoi që për çështjet sociale të kishte më shumë fond, u hodh dikush nga ju që të jetë për mu tha unë e heq fare këtë dhe debati ishte se përse nuk shkoni dhe ja thoni njerëzve në zona kur shkoni me i kërku votën. Ju thoni njerëzve që ne ua heqim edhe 50 mijë lekëshin që kanë nevojë.

Hekuran Markola : Kryetar do i përgjigjem.

Ani Dyrmishi: Të lutem, se nuk ta përmendi emrin, se pataj fillojmë me debate. Është mendimi i tij. Tani vazhdojmë.

Koment për pikën 1 kemi më? Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Miratohet me 42 vota pro pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Ligjor pasi mori në shqyrtim dokumentacioni e dërguar nga Bashkia Durrës vendosëm për ta kaluar me shumicë votash, por propozojmë tek neni 3 të heqim togfjalëshin “me sipërfaqe rreth 8.4 Hektar”, për pjesën tjetër jemi dakort. Faleminderit .

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola

Hekuran Markola : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike pasi shqyrtoi dokumentacionin e ardhur me email e kaloi me shumicë votash.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Jonada Mamo.

Jonada Mamo : Përsëritje.

Edhe komisioni jonë e kaloi me shumicë votash këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Po z. Muka.

Ardian Muka : Kisha një koment të paktën nga ana formale, për mënyrën se si na është paraqitur dokumentacioni në lidhje me pikën 2. Me insistimin tonë në dy komisionet si të pronave dhe atë të zhvillimit urban, mu dha fjala kam votuar kundër për një qëllim. Thashë nga ana formale projekti i këtij zhvillimi kaq të rëndësishëm për qytetin dhe këtu dua ta theksoj se ne si forcë politike dhe unë personalisht jam për zhvillimin e qytetit. Kemi qenë për zhvillimin e kësaj zone nga viti 2010, 2011, 2012 në atë kohë në KRRT-në e bashkisë Durrësit. Kemi propozuar që në atë kohë zhvillimin aty në atë zonë, se me atë stadium nuk mund të zhvillohen ndeshje ndërkombëtare, se në atë kohë si skuadër si në nivel nacional dhe atë internacional ne ishim goxha mirë. Për këtë pikë po thoj, që projekti na ka ardhur mbrëmë në orën 19.00. Unë i kisha shkruar zonjës sekretare më përpara, që mundësisht të na veni më shumë informacion se vetëm ato që kishin ardhur, relacioni, kontrata, aktmarrëveshje apo ato ç'ka do të lidhni midis palëve, për mendimin tim ishin të pamjaftueshme për të arrit në një koncept për atë propozim që na kërkohet .

E dyta po nga ana formale na keni sjell një kështu karton animat nga një person, për mu Edi Rama është një person civil, në facebook-un e tij mund të postoj çfarë të dojë. Po të më vinte nga Kryeministri Shqipërisë, e du se du, ai është Kryeministri im, pra nga ana formale bashkia duhet të jetë më e kujdesshme, se ky parlament i qytetit nuk është më njëngjyrësh, fal zotit këtu përfaqësohemi të gjithë.

Tani fillojmë me detajet teknike dhe konstatojmë që nga materialet që na keni sjellë sipërfaqe, meqë bashkia do trajtoj sipërfaqen, në 4 akte ka 4 vlera të ndryshme. Sipas akteve të pronësisë që na janë vënë në dispozicion, totali i tyre është 66203.75 m², sipas inventarit të pronave shtetërore të bashkisë së Durrësit janë 65.068 m² sipërfaqe në funksion të sporteve dhe 3.271 m² janë sipërfaqe rrugë, pra totali shkon diku tek 69.000 m². Në një akt tjetër që është marrëveshja mes palëve e lidhur me FSHZH-në, në aneksin nr.1, flitet për 70.000 m², ndërkohë që në

relacion na është referuar 84.000 m². Pra, nëse bëjmë një diferencë flasim për rreth 16 mijë, 17 mijë m² diferencë. Tani dëgjova zonjën e komisionit të heqim fjalën 8.4 hektar nga relacioni, por kjo nuk do të thotë asgjë. Unë si specialist dhe ata që kush ka patur mundësi ta lexoj, ky material sot kështu siç është, është i pasaktë në m², prandaj dhe në komision votova kundër dhe kërkova që të bëhet qartësimi i materialit. Kërkova që të marrim kohë, të qartësohet ky material, pa hyrë dhe tek fazat e projektit se dhe për atë do t'i them dy fjalë se për mendimin tim nuk qëndrojnë. Por kjo është shumë e rëndësishme, meqë bashkia ka tokën nga do hapet procedura për zhvillimin e kësaj prone, kështu siç është sot kështu me letra është e paqartë. Sa metra do japi bashkia ? Dhe kjo do hapi një problematikë të mëtejshme nesër, se nëse do japim shifra të gabuara do të rikthehemi vendimeve, prandaj do ishte mirë që të sqarohet kjo pikë kush merret Zyra e Urbanistikës apo problemet e pronësisë, që të jemi të qartë dhe akti të dal i saktë, jo 4 vendime , 4 sipërfaqe të ndryshme, e para.

Përsa i takon projektit u tha dje në 2 komisionet si të pronave dhe atë të zhvillimit urban, që tashmë kjo është një gjë e kryer. Unë them që duhet të heqim dorë nga faktet e kryera, sepse jemi këtu për të diskutuar, jemi këtu për të diskutuar për të ardhmen e qytetit, për të ardhmen e fëmijëve tanë, një qyetet që e shohim sot e kësaj dite që betonizohet gjithmonë e më shumë dhe ne kemi nevojë për më shumë gjelbërim, për më shumë zona sportive dhe prandaj e thashë në fillim që jam dakort që ajo zonë të zhvillohet, por jo sipas propozimit që ka ardhur, pas projektit që është miratuar. Pse ? Në atë sipërfaqe që është, tani është 8.4 apo 6.4 Ju takon juve që ta sqaroni zhvillohen rreth 105630 m².

Rolant Xhelilaj : Mund të ndërhy për procedurë.

Ka dal jashtë asaj. Nuk jemi këtu që të analizojmë projektin.

Ardian Muka : Z. Xhelilaj unë e bëra pjesën time të komentit për aq sa ne jemi direkt të prekur, pastaj pjesa tjetër është se duke thënë që ne po bëjmë rinovimin e stadiumit të zonës sportive dhe realisht po ndërtojmë një lagje, sepse kemi hoteleri me 15 kate, kemi një bonboliera që se di çka është apo një hotel që qenka në funksion sportit 4500 m², hotel me 8700m², sporte dhe aktivitete kulturore 5600 m², kemi një godinë 20 katëshe 15800 m², kemi zonë komerciale dhe zyra 17900 m², kemi zonë komerciale dhe rezidenciale, pra banesa për 12400 m². Pra, bashkia e Durrësit po kërkon të rehabilitojë një zonë sportive dhe ndërkohë po kërkon të jetë pronare hotelesh, zyrash dhe zonash komerciale. Në konceptin tim nuk shkon. Ne nuk kemi qenë pjesë e këshillit të mëparshëm, por detyra e projektimit e bashkisë nuk e di si ka qenë, por nuk besoj që ka qenë kjo, ose në qoftë se zotëritë e projektit kanë dalë nga projekti. Thashë për ne, për aq sa na takon , na takon të bëjmë kontestime, pra flasim për godina hotelerie 20 katëshe, 15 katëshe, 12 katëshe, në një zonë që FZSHH në Korçë ka bërë të njëjtën ndërhyrje, ka zhvilluar 2 fusha futbollit, 2 calcetto (kalçeto), palestër multifunkionale, 5 fusha tenisi, 5 fusha basketbolli, volejbollit dhe nuk ka një godinë. Pse ne këtu këtë sipërfaqe që kemi mos ta vëmë në funksion të sportit.

Ani Dyrmishi : Të lutem duhet të shkurtosh pak fjalim se koha është e kufizuar.

Ardian Muka : Tashi ne po flasim për një investim të Durrësit ku bashkia do të marrë një investim rreth 60 milion euro.

Ani Dyrmishi : Kuptoj, por dhe koha është e kufizuar se do flasin dhe këshilltarë të tjerë.

Ardian Muka : Ky është i vetmi argument ku ne do të kemi debat.

Kontjana Kuçi : Sa për kohën s'ka problem, z.Muka le të vazhdojë pasi me të njëjtin mendim jemi dhe ne. Ky material ka ardhur me shumë vonesë dhe kërkon kohë për tu parë, pavarësisht se ne parimisht jemi dakort që zona të zhvillohet dhe të marr zhvillimin e duhur. Nuk na prish punë që po na merr kohën, pasi mendimi është po i njëjti.

Ani Dyrmishi : Apsolutisht nuk kam asnjë problem me diskutimin, z. Muka le të vazhdojë, por mora të drejtën për t'i thënë që koha është e limituar dhe s'mund të flasësh pa limit.

Ardian Muka : Besoj do të jem brenda limitit.

Thashë kemi një investim që flitet 59 milion euro, por që për bashkinë e Durrësit mbi 3/4-tat e kësaj vlere shkon në hoteleri, zyra komerciale e zona rezidenciale. Them që qyteti në atë zonë të kishte park, tu zhvillonte e gjitha në funksion të sportit. Krijonim palestër tjetër multifunktionale, të krijonim fusha tenisi, fusha basketbolli, volejbolli të hapura dhe të mbuluara. Nuk kemi nevojë besoj si pronë bashkia të ketë 20 kate hotel e zyra. Kjo ka lidhje me vizionin e bashkisë, ka lidhje se si ka qenë detyra e projektimit dhe mënyra se si është konceptu pastaj projekti.

Në këtë pikë unë do të kërkoja kohë dhe do të propozoja që këtë pikë ta shtyjmë në një moment tjetër si për sqarimin e sipërfaqes se është i rëndësishëm se këtu nuk është e qartë, por edhe për mënyrën si është propozimi juaj. Faleminderit .

Ani Dyrmishi : Po, kryetare.

Emiriana Sako : Faleminderit, kryetar.

Problemi është që të bimë dakort që është zonë e cila do zhvillim. Sigurisht që nuk mund të përputhet vizioni i viteve përpara me një koncept aktual. Sot ju diskutoni projektin. E para që është çuar brenda afatit si dhe relacioni që ne miratojmë sot. Ne sot miratojmë përdorimin e pronës me FSHZH, nuk miratojmë projektin. Projekti ka pas një juri ndërkombëtare dhe është iniciativë e qeverisë shqiptare, ku bashkia e Durrësit është përfutuese si dhe pjesë e dokumentacionit, specifikimeve, termave, marrjes në dorëzim të projektit, i cili ka qenë publik. Përveç se është bërë në Pallatin e Kulturës të qytetit të Durrësit, ka qenë në rrjetet sociale që ju përmendët është dhe në faqen e AKPT-së, plus është dhënë dhe në media lokale, pra është bërë maksimumi për informimin e qytetarëve për të qenë pjesë e këtij konkursi. Pas konkurimit, bashkia ka marrë në dorëzim të treja kopjet nga kompania fituese dhe vlerësimin e jurisë me një dokument. I kemi kërkuar FSHZH të fillojë investimin në këtë zonë. Është një projekt i qeverisë dhe kemi kërkuar që dhe investimi të jetë i saj, sepse mendojmë që bashkia s'ka

kapacitete për ta ndërtuar vetë. Plus FSHZH ka investuar shumë në bashkinë e Durrësit duke sjellë investime në 2021 rreth 9 milion dollar investime, pra punë në terren, këtu përfshin shkolla, rrugë dhe në 2022 rreth 13.1 milion dollar, pra do të thotë që kemi bashkëpunim shumë të mirë me këtë institucion, për të vijuar më tej dhe këtë investim që e shohim shumë të rëndësishëm. Projekti është kompleks dhe nuk mund shihet apo diskutojmë rreth 10 minuta që kemi në këtë formë që po flasim. Këndvështrimi që doja ta shikoja unë, pasi ju e shikoni në këndvështrimin tuaj dhe politik, është që në këtë investim përveç se do të ndërtohet një stadium me 10 mijë vënde, do ketë terrene sportive, do ketë objekte publike që do të shërbejnë bashkisë, do të ketë ambiente zyra që do të shërbejnë për nevojat që do të ketë institucioni, për të zhvilluar konceptet e reja të punës sot domethënë. Projekti është konceptuar si publik dhe privat. Këshilli Bashkiak sot nuk miraton projektin, por miraton marrëveshjen e bashkëpunimit midis FSHZH, Bashkisë së Durrësit, Ministrisë së Arsimit dhe AKPT-së , të cilat janë marrë me këtë projekt dhe do të iniciojnë procedurën për fazën e parë të investimit me infrastrukturën. Kryesisht me fondet e rindërtimit kemi patur këtë ekperiencë pune. Edhe në lagjen re ata kanë nisur punën me infrastrukturën, mund ta vazhdojë FSHZH, mund ta vazhdojë një institucion tjetër, kjo mbetet për tu parë. Këtë ne nuk e dimë sot, dhe do të informoheni rast pas rasti pasi këshilli bashkiak është pronar i pronës. Dhe në zonën e stadiumit mund ta quajmë qendër të Durrësit me zhvillimin urban që ka marrë qyteti në dekada dhe e shohim si një mundësi shumë të mirë, e shohim si një pol tjetër ekonomik, social kudo kemi mundësi të kemi aktivitete mikse, që nga sporti që është primar, indicia pse bëhet ky projekt deri tek realizimi i shumë shërbimeve të tjera. E mbi të gjitha ky projekt, pavarësisht se ju nuk e përmendët ka një hapësirë të konsiderueshme për shtimin e hapësirave të gjelbërta në qytet, sepse ky projekt konceptohet për të qënë i hapur dhe për të pasur hapësira publike. Përsa i takon sipërfaqes është një lapsus që është bërë nga administrata e bashkisë, ju e keni shprehur shqetësimin dhe në komision. Ne kemi marrë përsipër ta rregullojmë në bazë të dokumentacionit të pronës që e kemi të azhonuar në hipotekë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare.

Koment tjetër?

Ju lutem përgjigja u dha, s'mund ta kthejmë në debat.

Dritan Burgija : Po kryetarit të grupit mund t'ja japësh fjalën.

Ani Dyrmishi : Po

Dritan Burgija : Ok. Kam këtu përpara marrëveshjen që keni me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, AKPT dhe FSHZH . Qëllimi i projektit: Dhënia përparësi për zhvillimin e hapësirave të rekreacionit dhe çlodhjes, të cilat kanë një inpakt të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e mikroklimës urbane, uljen e ndotjes së ajrit dhe efektet e ngrohjes globale. Tani me këto kullat do ndërhyjmë ne ngrohjen globale apo me pemët që mezi duken nga kullat? Do bëja një pyetje në fakt meqenëse thatë që këtu nuk diskutohet projekti. Sa nga këto banesa që parashikohen në këto kulla janë për njerëzit në nevojë, çiftet e reja, banesa sociale? Kaq .

Emiriana Sako: Nuk mund të flasim që sot për trajtimin e kullave, prioritet është stadiumi. Thashë që për çdo vendimmarrje të mëtejshme qoftë për procedurë, qoftë për informim publik ne do t'ju informojmë se si do të procedohet për ndërtimin dhe fillimin e punës. Fillimisht FSHZH do të filloj me hartimin e projekt-zbatimit . Ky projekt është një projekt që vjen nga një konkurs, pra është një projekt ide, do kalohet në projekt zbatimin e më pas do fillohet puna. Më tej se si do të shkojnë hapat bashkia dhe këshilli bashkiak do të marrë informacionin.

Dritan Burgjia : Dhe një pyetje . Do ketë më shumë fusha apo më pak?

Emiriana Sako: Më shumë .

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Koment tjetër?

Jonuz Myshketa : Mundem ?

Ani Dyrmishi : Po .

Jonuz Myshketa : Si përfaqësues i Partisë Demokratike shpreh se Partia Demokratike nuk është kundër asnjë projekti apo investimi që bëhet për qytetin e Durrësit. Kundërshtimi që kemi patur në komision ka qënë vetëm koha për të marrë në dispozicion materialin e projektit, pavarësisht se projekti është publikuar. Është një projekt me juri ndërkombëtare dhe pyetja ime është : Cila është marrëveshja e lëshimit të terrenit nga bashkia e Durrësit dhe ç'ka përfiton bashkia nga gjithë ndërtimi i projektit?

Emiriana Sako: Bashkia përfiton të gjithë investimin. Jo vetëm investimin , por dhe një front të ri, mundësi e re të zhvillimit të qytetit qoftë për turizmin, qoftë për qytetarët e Durrësit. Pra një zonë te re që do të jetë mundësi zhvillimi. Pra, përveç zonës së sporteve thashë pak më parë që kemi banesa publike, ambiente sportive, terrene përreth stadiumit, kemi një pishinë tjetër që ndërtohet për qytetin, hapësira publike dhe territore të gjelbërta.

Jonuz Myshketa : Është parashikuar ndonjë njësi akomoduese apo apartamente ?

Emiriana Sako: Nuk është një analizë që është bërë, është në fazën e një projekt ideje që do të përkthehet në një projekt zbatimi tani. Sot ne kërkojmë që të fillojmë projektzbatimin dhe investimin e infrastrukturës. Për hapat e mëtejshëm do ta tregojë projektzbatimi se si do konkretizohet ky projekt dhe si do vepron me gjithë zhvillimin e sipërfaqes së pronës.

Jonuz Myshketa : Dhe ç'ka merr bashkia për territorin që jep?

Emiriana Sako: Atë që zhvillohet.

Jonuz Myshketa : Dakort.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Atëherë koment tjetër ? Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Kujdes se ke të bardhë. Abstenim.

Abstenim ?

Dritan Burgija : Thjesht për çështje kohe se e bëri shumë mirë shpjegimin zoti Muka.

Rolant Xhelilaj : Kryetar mund të ndërhyj për procedurë.

Ani Dyrmishi: Po, z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Unë jam dakort që ju kaluat në votim, por në raste të tilla e mira është të merrni dhe opinionin e grupeve përkatëse.

Me këtë rast kam dëshirë t'i bëj një koment të vogël z. Muka për analizën që i bëri gjësë. Jam dakort me pjesën e parë dhe i qëndroj pjesës së parë. Gjithë pjesa tjetër është një përpjekje për të mbajtur një qëndrim politik se ka pas kohë plot që ke tenderi pa u zhvilluar, duke patur parasysh si një kërkesë e hershme e qytetit të Durrësit për një stadium modern, por edhe për një qendër të re zhvillimi siç është ajo zona aty, zonë shumë e bukur që ka nevojë dhe për ato objekte që do të ndërtohen. Edhe në këtë pikë dua ta theksoj se ai cinizmi i Kryeministrit për këto zhvillime le të jetë, le të mërzhitet pak Ardi dhe ça përfaqësojnë forcat e tjera politike. Të gëzohet qyteti i Durrësit, të gëzohen qytetarët, jemi të gjithë të kënaqur me zhvillimin, edhe të qëndrave të reja, por sidomos sportit ku jemi dhe tifoz dhe grupi jonë i PS është i tëri unik në miratimin e marrëveshjes, duke bërë dhe korrigjimin përkatës që u ngrit me të drejtë nga z.Muka. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z.Xhelilaj.

Ardian Muka : Meqë mu përmend emri.

Ani Dyrmishi: Po.

Ardian Muka : Atë që thashë pjesën e materialeve nuk e thashë fare për cinizëm. Duhet të jenë më të kujdesshëm se nëse do të na vinte materiali nga Kryeministri i Shqipërisë thashë ai është Kryeministri im. Nuk na ka ardhur materiali nga Kryeministria, por na ka ardhur nga një faqe personale. Unë them që ju duhet të bëni më kujdes.

Emiriana Sako : Thashë që materiali ka dal dhe në media .

Ardian Muka : Them për linkun që na ka sjell bashkia. Materialin që na ka sjell bashkia. Nuk dua të fajësoj njeri këtu, por duhet të jeni më të kujdesshëm. Tek patronazhistët dërgojeni, këtu bëni më kujdes. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Me 34 vota pro dhe 8 kundër miratohet pika 8 e rendit ditës me ndryshimet që u thanë.

Ardian Muka : Sa janë ?

Ani Dyrmishi: 34 vota pro dhe 8 kundër.

- Kalojmë në **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar.

Komisioni ynë pasi mori në shqyrtim pikën 3 propozon për ta kaluar në votim me shumicë votash. Faleminderit .

Kontjana Kuçi : Jemi më shumë.

Ani Dyrmishi: Ngrejeni dhe njëherë kartonin.
1,2,3, 9 vota . 9 keni.

Ardian Muka : Sa abstenim?

Ani Dyrmishi : S'ka asnjë abstenim.

Atëherë të korrigjohet pika 2 miratohet me 33 vota pro dhe 9 abstenim.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola

Hekuran Markola : Komisioni i Pronave Publike propozon për ta kaluar në votim me shumicë votash.

Ani Dyrmishi : Atëherë komente përsa i përket pikës 3 kemi?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?... 9

Abstenim ?Nuk ka.

Dritan Burgija : Dhe një herë na falni se u ngatërruam. Jemi pro.

Ani Dyrmishi : Atëherë me 42 vota pro miratohet pika 3 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar.

Komisioni ynë pasi mori në shqyrtim pikën 4 propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike propozon me shumicë votash për ta kaluar në mbledhjen e këshillit bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë komente përsa i përket pikës 4 nga ana e këshilltarëve?

Dritan Burgija : Sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me rindërtimin me thënë të drejtën kemi konstatuar problematika, por duke qënë se nuk duam të zgjatemi do fillojmë të hyjmë në cici-mice në muajt në vazhdim do kërkonim një komision investigimi dhe t'i hym me themel kësaj pune sepse preferoj mos bëj komente sot dhe do t'i abstenojmë gjithë problemet sot që kanë të bëjnë me rindërtimin.

Ani Dyrmishi : Ok. Komente tjera? Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?9.

Atëherë me 33 vota pro dhe 9 abstenim miratohet pika 4 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Rroshi.

Alneida Rroshi : Pas shqyrtimit të relacionit dhe projektvendimit të pikës 5 jemi dakort për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe Komisioni ynë propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 5?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?9.

Ani Dyrmishi : Atëherë me 33 vota pro dhe 9 abstenim miratohet pika 5 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Rroshi.

Alneida Rroshi : Pas shqyrtimit të pikës 6 propozojmë me shumicë votash për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe Komisioni ynë për pikën 6 me shumicë votash propozojmë që të kaloj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 6 nga këshilltarët ka?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?

Ani Dyrmishi : Atëherë me 33 vota pro, 8 abstenim dhe 1 pa votuar miratohet pika 6 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 7**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Rroshi.

Alneida Rroshi : Pas shqyrtimit dhe të pikës 7 propozojmë me shumicë votash për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe kjo pikë e rendit të ditës u miratua nga komisioni ynë me shumicë votash.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 7, ka nga këshilltarët ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?

Ani Dyrmishi : Atëherë me 33 vota pro, 8 abstenim dhe 1 pa votuar miratohet pika 7 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 8**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave e Tarifave Vendore z.Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Komisioni pas shqyrtimit e kalon këtë pikë për miratim në këshill bashkiak.

Ani Dyrmishi : Përsa i përket pikës 8 komente nga ana këshilltarëve ka?

Dritan Burgija : Pika 8, po.

Dje në komision bëra një pyetje në lidhje me taksën vedore të biznesit të vogël. Domethënë vihet re që 2021 është 27951 milion, 2022-shi është 5572 milion, 2023-shi 39500, pra 8 herë më lartë nga 2022-shi. Dhe përgjigja që mu dha ishte eficaenca më e mirë e mbledhjes së taksës. Pyetja është: bie dakort që paska qenë eficaenca në mbledhjen e taksës. 2024,2025,2026 prap parashikimet janë 5000 në një nivel me 2022. Ça ka, do ju bie eficaenca? Kjo është pyetja.

Rolant Xhelilaj : Përgjigjen do ta marrësh nga bashkia, por përgjigja nuk qe kjo.

Përgjigja ishte se është një marrëdhënie midis bashkisë dhe organeve tatimore që bashkëpunojnë për mbledhjen e të ardhurave sipas detyrimeve të biznesit të vogël dhe është rregullimi i raporteve të dorëzimit të të ardhurave të mbledhura, përgjigja. Pastaj nëse për këto z.Burgija kërkon investigim, bashkia këtu është, por përgjigjen e more në komision dhe nga përfaqësuesi i bashkisë.

Dritan Burgija : I nderuar z. Xhelilaj, natyrisht që ishte kjo përgjigja, por pas insistimit tim. Por përgjigja e parë ishte kjo, që bashkia ka qënë eficaente në mbledhjen e taksave për biznesin e vogël.

Rolant Xhelilaj : Nuk dua të bëj debat .

Dritan Burgija : Nuk duam të bëjmë debat. Mirë.

Rolant Xhelilaj : Këtë e ngriti z. Myshketa dhe s'ka lidhje me pyetjen që bëre ti.

Dritan Burgija : Nëse duan të japin përgjigje mirë, pyetjen e bëra.

.... del në mikrofon z. Luan Dajko, Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkisë....

Ani Dyrmishi : z. Myshketa.

Të mbaroj njëherë z. Myshketa, që mos kemi përsëritje.

Jonuz Myshketa : Atëherë diskutuam në Komisionin e Buxhetit për buxhetin afatmesëm, pamë që kishte një rritje të mbledhjes së taksave, është e kuptuar prandaj shtruan dhe pyetje dhe parashikimet mund të vinë në gjykimin tim që u diskutua dhe në komision. Shtimi i bizneseve dhe kjo sjell rritjen e të ardhurave në buxhetin e bashkisë përmes taksave. Atë gjykoj unë dhe që bashkia ka tagër, sipas hulumtimeve që kemi efienca e mbledhjes së taksave lë për të dëshiruar në disa aspekte. Kjo përbën arsyen kryesore të rritjes së buxhetit. Në gjykimin tim bizneset nuk ankohen se taksat janë të larta, por duhet krijuar një klimë që taksat që vilen të përkthehen në shërbime dhe të ketë efienca në mbledhjen e taksave. Një pyetje kam. Autortiteti Portual si është në lidhje me pagesat e taksave vendore në lidhje me bashkinë e Durrësit.

Ani Dyrmishi : z. Dajko mund t'i përgjigjesh pyetjes së z. Burgija e më pas z. Myshketa.

Luan Dajko : Me z. Burgija në radhë të parë.

Përshëndetje njëherë se është hera e parë që takohemi me këshillin bashkiak të ri.

Nuk ka ndryshuar asgjë nga taksat në bashkinë e Durrësit. Pas 3 vitesh të vështira nga tërmeti, pandemia është viti i parë që në muajin qershor, edhe pse kemi patur problematika të trashëguara, të realizojmë në muajin qershor edhe duke shtyrë afatin nga 20 prill në 31 maj, për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve, të realizojmë 50 % të të ardhurave duke rritur 12% buxhetin e bashkisë.

Si është rritur buxheti? Buxheti nuk është rritur duke rritur taksat dhe tarifën, përveç rasteve kur kërkohet nga Tatimet, sepse biznese të caktuara kalojnë në biznes të madh. Biznesi madh nga biznesi vogël dallon nga tarifën. Këto tarifa e sigurtë që shkojnë në shërbim të biznesit, sepse ndriçimi shkon për ndriçim, pastrimi shkon për pastrim, gjelbërimi shkon për gjelbërim dhe taksa e pasurisë është me vendim qeverie që nuk ndryshon dhe ka një çmim mesastar për qytetin e Durrësit që shkon 67500 lekë m². Asgjë nuk ka ndryshuar dhe rritja të ardhurave vjen nga rritja e efiençës. Kemi një problem që vjen nga Ministria e Financave dhe Qeveria që kalimi nga biznesi i vogël në biznes të madh nuk varet nga ne, gjithashtu ka probleme që na kanë dalë 4, 5 vjet përpara nuk arrijmë dot të ndryshojmë tarifën nga i vogël te i madh, se një biznes kalon për ndërtimin nga 200000 në 700000 ose për karburantin nga 200000 në 500000 dhe nuk varet nga bashkia e Durrësit. Ne kemi vetëm një, biznes i madh, biznes i vogël dhe nivelin e tarifave. Në momentin që na i bie Tatim Taksat ne zbatojmë vetëm detyrimin që ditën që ata e kanë sjellë. Kurrë s'kemi gabuar në një ditë me këto taksa e tarifa. Bashkia e Durrësit është bashkia që ka tarifën më të ulët në të gjithë Shqipërinë.

Dritan Burgija : Z.Dajko bëra pyetje pse lëvizin taksat 8 herë më shumë në 2023 dhe parashikimi është 8 herë më pak . Domethënë pse 2023 është 39000 dhe 2024, 2025, 2026 është 5000.

Luan Dajko : Nuk janë rritur taksat.

Dritan Burgija : Nuk është janë rrit apo jo, efienca.

Luan Dajko : Zoti Burgija s'kemi asnjë rritje 2024, 2025. Jemi munduar të rrisim gamën e atyre që duhet të paguajnë, jo të rrisim tarifën. Ky është viti më triumfator, që realizojmë të ardhurat në gjysmën e 6-mujorit. Jemi aq mirë, sa nuk kemi qenë kurrë, të paktën kaq vite që punoj unë dhe madje pa rritur taksa e tarifa. Deri në 2025 me 2 % që është me vendim qeverie. Kërkoni të ndërtohet, kërkoni për sportet, për kalamajtë, për kopshtet. Nuk kemi asnjë rritje tarifash, fare.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. z. Dajko.

Dritan Burgija : Z. Kryetar mund ta marrë dhe njëherë fjalën? E di që u mërzi.

Ani Dyrmishi : Meqë në komision bëhen paraprakisht këto pyetje Ju duhet ta bëni pyetjet në komision se këtu i bjen që nuk maron asnjëherë diskutimi. Ai kthen përgjigje ti kthen përgjigje.

Dritan Burgija : Komision i shpreha unë këto, e dua t'i shpreh dhe këtu.

Ani Dyrmishi : Po nuk mund t'i shprehësh pa fund, se diskutimi midis teje dhe bashkisë nuk mbaron asnjëherë. Ti e kupton shumë mirë çfarë po them.

Dritan Burgija : Prandaj na kanë votu që të vonohemi këtu e të zgjidhim ndonjë gjë.

Ani Dyrmishi : Po, por kjo duhet bërë në komision.

Po z. Burgija.

Dritan Burgija : Gjëja tjetër që vihet re tek parashikimet, rrjeti rrugor rural 2024 është 220 milion, 2025 është 349 milion, si kjo ka, po themi dhe shërbimet publike vendore 110 milion, 342 milion për 2025 ka ndonjë shpjegim domethënë. Unë do të sugjeroja që shpërndarjen ta bënim më mirë në vite se kuptohet për çfarë është bërë, pasi 2025 është vit elektorale dhe t'i shërbejmë këtyre qytetarëve jo vetëm 2 muajt e fundit, siç ndodhi në zgjedhjet e fundit ku 2 muaj me atë intesitet shtrim rrugësh, legalizime e ku di unë, t'i shërbehet gjatë 4 viteve me intesitet të ngjashëm me atë të 2 muajve.

Emiriana Sako : Intesiteti i punimeve në terren që pas tërmetit ka qenë i lartë dhe nuk është përfshirë fare në fushatë, pra ka qenë i njëjti, por ju vëzhgoni periudhën e fushatës se atëherë jeni vigjilent.

Dritan Burgija : A domethënë nuk jemi vigjilent për pjesën tjetër.

Emiriana Sako : Patjetër .

Këto linja që kemi propozuar ne nuk ka lidhje fare me 2025, pra me kohën e zgjedhjeve. Por se duhet të kuptoni se ky nuk është një buxhet që miratohet tani. Ky është një vendim i këshillit bashkiak, i cili shkon në Ministrinë e Financave për fillimin e procedurës për hartimin e

buxhetit. Hartimi i buxhetit bëhet me dëgjesa publike që shtrihet gjatë muajit shtator-tetor që do të ftoheni dhe do ta shohim se sa do të vini . Do ju ftoj të jeni prezent që të shprehni kërkesat që keni. Dhe pasi të bëhen dëgjesat publike miratohet dhe paketa fiskale nëse do të ketë ndryshime, miratohet buxheti për vitin që vjen, për tre vite. Pavarësisht se miratojmë tre vite ekzekutiv është vetëm viti pasardhës. Pra ne miratojmë në dhjetor të 2023 buxhetin afatmesëm për 3 vite dhe ekzekutojmë 2024 dhe kjo punë vazhdon çdo vit duke patur një mbivendosje praktikisht në 2 vite. Kjo ishte sa i takon.

Sot ne miratojmë në linja të përgjithshme, themi 220, por pa e specifikuar cilat janë nevojat, sepse themi që do shkojnë në rrugë rurale, pasi do shkojmë në çdo njësitë administrative me qytetarët, me këshillin bashkiak dhe do themi ku i doni rrugët, ku i doni shkollat, ku i doni koshat e plehrave, ku i doni stacionet e autobuzave dhe këto do të detajohen me zëra dhe emra konkret më pas. Faleminderit .

Ani Dyrmishi : Faleminderit kryetare.
z. Myshketa

Jonuz Myshketa : Një pyetje kisha për z. Dajko. Ajo që më intereson është që të jetë një bashki sa më efiçente. A mund të di prej jush se cilat janë masat e efiçencës së vjeljes së taksave që të administrohet sa më mirë marrja e tyre. Dhe cilat janë masat që keni marrë ose që do të ndërmerren në rritjen e efiçencës në vjeljen e taksës?

Luan Dajko : Mund ta përsëritësh dhe njëherë pyetjen.

Jonuz Myshketa : Ajo që më intereson është një bashki efiçente në mbledhjen e taksave në gjithë territorin e bashkisë dhe pika 2 është që këto taksa të përkthehen në shërbime se ky është sensi i taksave dhe tatimit. Dhe cilat janë masat që keni marrë për rritjen e efiçencës së vjeljes së taksave në gjithë territorin ku administron bashkia e Durrësit në raport me vitin e kaluar ku besoj se ka patur deficiencë në mbledhjen e taksave.

Luan Dajko : Sapo ju thashë që është viti i parë pas 2 viteve të vështira që kaloi bashkia, shumë të vështira duke menduar që janë 3480 subjekte që janë sezonal nga Gjiri Lalëzit deri tek Shkëmbi i Kavajës dhe nuk është e lehtë dhe në kuptimin e performancës dhe sepse biznesin e kemi partner dhe jetojmë me biznesin. Them që 14800 biznese, që për këto tre vite të vështira që nga pandemia, tërmeti dhe problemet që kemi kaluar dhe kemi një performancë absolute duke u rritur 12 % në buxhet, nga 1 miliard 748 milion kemi shkuar 2 miliard e 78 milion, 2 miliard e 100 milion lekë. Pra të rritesh 12 % në një situatë të vështirë. Duhet të rrisim bazën e bizneseve, të luftojmë informalitetet, të luftojmë problematikat që kemi patur. Kemi patur dhe problematika të tjera në raport me atë që kërkohet në një qytet, me rregullin e qytetit, me kalimin e rrugëve, të planifikojmë një buxhet për hapësirat publike, etj etj, për të cilat i lëmë qytetarëve hapësira dhe liri , që në plazhe, që në sipërfaqet që kemi, duke ndërhyrë në buxhet qoftë dhe në periferi. duke rregulluar bazën që të shtohen bizneset, që të paguajnë pa rritur nivelin e taksave dhe tarifave dhe ja kemi arritur kësaj pune. Asnjëherë nuk ka qënë deri më sot

që të ketë 50% të realizimit të buxhetit vjetor duke shtyrë dhe afatin e pagesave dhe duke patur dhe probleme dhe duke pastur dhe trashëgimi problemesh. Them që kemi bërë më të mirën e asaj që mund ta bëjmë, jo se nuk kemi probleme, por është një performancë shumë e mirë deri më sot. Mendoj që 6 mujori i dytë do të jetë shumë më mirë se i pari.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z.Dakjo .

Jonuz Myshketa : Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë komente të tjera ka?

Nuk ka. Kush është pro pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?9.

Atëherë me 33 vota pro dhe 9 abstenim miratohet pika 8 e rendit të ditës.

Dritan Burgija : Z. Kryetar më duket se nuk i ke 33.

Dorina Milja : Dritani doli me telefon, por ka hyrë dhe votoi.

Dritan Burgija : Unë nuk shoh mbrapa, por më njoftuan që mungonte.

Ka lidhje me vigjilencën që na tha Kryetarja.

Ani Dyrmishi : Kalojmë në **pikën 9**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores, pas shqyrtimit të pikës 9 propozojmë me shumicë votash për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe Komisioni ynë pikën 9 e kaloi me shumicë votash.

Kam një koment. Nuk e kuptoj pse dje komisioni ynë votoi me shumicë votash, nuk kishte ndonjë koment nga këshilltarët dhe sot abstenojnë.

Edlira Shemsi: Më fal, në komision ne diskutuam, problematika ishte se ka qytetarë që nuk kanë marrë bonuset e qerasë dhe në lidhje me qytetarët që përfitojnë dhe kundërshtitë që mund të kenë patur në lidhje me sipërfaqet. Dhe u relatua që janë anku qytetarët dhe janë rivlerësuar.

Joniada Musaraj: Pyetja ishte jashtë fare objektit tonë dhe pasi të dhashë përgjigje the se ishe shumë e qartë.

Edlira Shemsi : Jo s' ishte fare jashtë objektit. Pse janë rivlerësimet? Janë rivlerësime se ka patur ankesa nga qytetarët. E dyta në lidhje me bonuset që qytetarët thonë s' janë marrë.

Ani Dyrmishi : Komente përsa i përket pikës 9 kemi?

Nuk kemi. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?9.

Atëherë me 9 abstenim dhe 33 vota pro miratohet pika 9 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 10**, i japim fjalën znj. Rroshi Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike.

Alneida Rroshi : Pasi shqyrtoam dhe pikën 10 propozojmë me shumicë votash për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe Komisioni ynë e votoi me shumicë votash.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 10 kemi nga ana këshilltarëve?

Nuk kemi. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?9.

Atëherë me 32 vota pro, 9 abstenim, 1 pa votuar miratohet.

- Kalojmë në **pikën 11**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi .

Alneida Rroshi : Komisioni i Rregullores pas shqyrtimit projektvendimit dhe relacionit është dakort parimisht për ta kaluar pikën 11 në votim, por duke bërë një ndryshim, të shtohet Ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Ndërmarrja Rrugë dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e vendimit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola

Hekuran Markola : Komisioni i Pronave pasi mori në shqyrtim pikën 11 me shumicë votash vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj.Luarasi

Denisa Luarasi : Edhe komisioni ynë me unanim votash ra dakort që të kaloj sot për votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 11 kemi nga ana këshilltarëve?

Koment nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është dakort miratimit me ndryshimet përkatëse të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka .

Atëherë me 42 vota pro, miratohet.

- Kalojmë në **pikën 12** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Rroshi .

Alneida Rroshi : Pas shqyrtimit të pikës 12 ramë dakort për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Markola

Hekuran Markola : Edhe komisioni ynë pasi mori në shqyrtim pikën 12 me shumicë votash propozon ta kaloj për votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Jonada Mamo.

Jonada Mamo : Edhe komisioni jonë e miratoi me shumicë votash këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 12 ka nga ana këshilltarëve?

Koment nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka .

Atëherë me 1 abstenim , 41 vota pro, miratohet pika 12 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 13** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Rroshi .

Alneida Rroshi : Pas shqyrtimit të relacionit dhe projektvendimit të pikës 13 me shumicë votash propozojmë për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Markola

Hekuran Markola : Komisioni Pronave pasi shqyrtimit të kësaj pike, me shumicë votash propozon për ta kaluar për votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 13 ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 41 vota pro, 1 pa votuar miratohet dhe pika 13 dhe e fundit e rendit të ditës.

- Kanë kërkuar fjalën **për dikutim**. Znj.Shemsi fillon, përgatitet Flutura Kasa, Jonuz Myshketa dhe Kontjana Kuçi.

Edlira Shemsi : Kisha përgatit disa kërkesa, pyetje për Kryetaren e bashkisë dhe këshillin të diskutonim.

E para çmimi i ujit në m³ është disa fish më shumë se mesatarja kombëtare. Kush është arsyea, çfarë do bëhet në lidhje me këtë ?

Tjetër në bazë të ligjit nr.7889, datë 14.02.1994, neni 16 “Invalidët përjashtohen nga taksat direkte të bashkisë, këtu bëjnë pjesë taksa e pastrimit, e gjelbërimit. Përveçse paguajnë taksën e pasurisë, nga këto taksa duhet të përjashtohen.

Transparenca që duhet bërë në lidhje me plazhet publike. Aktualisht të vihen në dispozicion hartat ku janë vendosur plazhet publike, ato të shënjohe qartë nga punonjësit e bashkisë. Dhe transparenca për privatët, sa taksa i sjellin bashkisë sipas kuponit tatimor.

Problematik tjetër që ngrita është shtimi i hapësirave të gjelbërta . Çfarë po bëhet me shtimin e hapësirave të gjelbërta? Si janë masat që do vazhdohet për gjelbërimin e qytetit?

Gjithashtu mendoj se duke qënë një qytet turistik duhen dhe banjot publike. Një qytet pa banjo publike më duket non sens.

Në lidhje prap me invalidët. Ligjin mbi "Për Aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar", në bazë të VKM-së 1074/2015, çfarë aksesu kanë ata duke qënë se janë më karrocë invalidësh, si është infrastruktura e ngritur që ata të kalojnë? Në bazë të rregullores për transportin që menaxhohet nga bashkia, në lidhje me mospagesën për transportin. Sa zbatohet kjo? Si ndiqet nga bashkia, nga inspektorët e bashkisë? Pasi ka ankesa nga invalidët se ata nuk pranohen dhe nuk kanë mundësi për të hipur dhe kështu nxit diskriminimin e tyre. Tjetër sa përçind e banesave sociale janë planifikuar për invalidët? Dhe atë që tha Dritani shparë për pjesën e minimumit jetik. Në komision ishte dhe Drejtoresha e Shërbimit Social të bashkisë dhe duke qënë se ne s’kemi një minimum jetik, cilat janë kriteret për përzgjedhjen e personave që përfitojnë ndihmën ekonomike? Pasi pa një minimum jetik cilat janë këto kriteret? Si dhe numrin total të invalidëve që marrin ndihmë ekonomike dhe jo vetëm të personave që marrin ndihmë

ekonomike, por dhe asistencë nga bashkia dhe për to si janë kriteret përzgjedhëse? Megjithëse për to nga drejtoresha u tha se ato na vijnë të gatshme nga komisionet jo drejtëpërdrejtë varen nga bashkia, por nga Ministria e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale. Dhe këto komisione janë bërë një kangrenë e vërtetë, pasi me regulloret e reja pacientët duhet të shkojnë në Qendrën Spitalore Universitare për të kryer ekzaminime e vizita, që kryen në çdo spital përfshirë dhe Durrësin, pasi po flas për Durrësin. Kuptohen kostot, vështirësia për të vajtur dhe unë e ngrita këtë kërkesë në komision. Nga anëtarët e komisionit u tha që mund të bëjmë një lloj kërkesë apo peticioni si mund ta quajmë pranë Komisionit të Shëndetësisë pranë Parlamentit apo dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Punëve Sociale. Unë këtë problem e has si mjeke çdo ditë, është një strapacim dhe një shkelje e të drejtave të sanksionuara me ligj, që ata ta marrin aksesin mjekësor aty ku janë. Flasin për gjëra që janë të mundura të bëhen. Ju faleminderit.

Më falni dhe për bonusin e qerasë fola dje në komision. Një pjesë e qytetarëve nuk kanë marrë bonusin prej 4 muajsh. Çfarë do të bëhet në lidhje me marrjen e bonusit, që nuk është marrë prej 4 muajsh?

Ani Dyrmishi : Po, Kryetare.

Emiriana Sako : Faleminderit për pyetjet.

Çmimi i ujit në bashkinë e Durrësit nuk është më i shtrenjti në Republikë, por është pas Korçës. Korça është më lartë se ne dhe ne jemi baraz me Bashkinë Patos, pra kemi një kuotë, që vendoset nga Enti Rregullator i Ujit duke marrë në konsideratë shumë komponentë që janë kostot, shpenzimet dhe investimet që ka ujësjellës-kanalizime, kapaciteti i vjeljes së të ardhurave. Të gjithë këto komponentë vlerësohen nga ky institucion dhe merret vendimi pastaj. Sigurisht që Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime mund ta çojë 100 lekë, po nuk do të thotë që ky propozim miratohet. Pra, ky institucion ka të drejtë të marrë vendim. Bëhet më dije këshilli bashkiak. Është bërë ndryshimi në 2017. Nuk kemi plan për të ndryshuar çmimin e ujit, por kemi plan për të rritur eficientë, pasi siç mund ta dini tani Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime tani ka dhe shumë bashki të tjera dhe janë çdo ditë në terren për të rritur eficientë. Duhet marrë në konsideratë që Durrësi i ka burimet relativisht larg, pra burimet ujore janë 60, 40, 30 km nga qyteti dhe kjo bën që gjithë stacionet e pompimit qoftë të ujësjellësit, qoftë kanalizimet të punojnë 24 orë me energji elektrike, që do të thotë që kostot e energjisë pagohen nga të ardhurat që vijnë kryesisht nga qytetarët.

Pika e dytë. Për heqjen e taksave kemi marrë 2 vendime një në 2021 për taksën e pastrimit dhe në 2022 kemi marrë 22.12. 2022 për invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit /bashkëshortes), përfituesit e ndihmës ekonomike, kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes), kryefamiljarët gra me fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç), janë hequr të gjitha tarifat e bashkisë. Është aplikuar, sigurisht ka raste që janë ankuar pasi është ngarkuar në faturën e ujit dhe rast pas rast me një grup nga bashkia e Durrës dhe Ujësjellës Kanalizime kemi marrë masa që anketa të ndiqet dhe të finalizohet për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

Transparenca për qytetarët për plazhet është në prioritetin tonë. Harta e plazheve ka dal, kemi bërë miratimin, është dhe në faqen e bashkisë, kemi bërë miratimin vitin që shkoi në nëntor, sepse ishte dhe periudha ku hapej thirja e subjekteve për të aplikuar. U desh të futej përsëri në këshill bashkiak, sepse plani vjetor që ishte futur një vit përpara ndryshoi raporti i hapësirave publike nga ato private 70 me 30. Kështu të gjithë elementët e hartës në zbatim të VKM-së së 2019-s janë online në faqen e bashkisë. Çdokush mund t'i shkarkoj, t'i shofi dhe madje mund të ndihmojë policinë bashkiake në rast abuzimesh. Kuponi tatimor nuk është detyrë as e bashkisë, as e taksave, por është detyrë e Drejtorisë së Tatimeve, kështu që ne nuk merremi me kuponin tatimor. Sigurisht nëse ju doni të dhëna sa janë të ardhurat për plazhet për bashkinë e Durrësit që nga 2020, ne mund t'ua vëmë në dispozicion.

Shtimi i hapësirave të gjelbërta është një prioritet që kam patur gjatë gjithë kohës që kam drejtuar bashkinë e Durrësit. Kemi bërë të mundur ndërhyrjen në disa zona në qytet, lulishtet "Hyrja e Durrësit", "Muzeu" ku janë bërë mbjedhjet e pemëve, janë bërë mbjedhjet e pemëve në "Shëtitoren Taulantia". Në këtë 3-4 vjeçar le të themi, janë rreth 4600 pemë të mbjedha në zona të ndryshme të qytetit. Për shtimin e tyre do të vazhdojmë me buxhet të përvitshëm për shtimin e hapësirave të gjelbërta. Normalisht qyteti ofron pak hapësirë publike sepse ka një konfigurim urban tashmë të vendosur, por ne do të punojmë me akset e qytetit ku nuk ka gjelbërim dhe do të shohim aty ku ka hapësira publike për të bërë krijimin e hapësirave për parqe dhe kemi disa projekte. Përveç lulishtes tek Vollga që është duke u përfunduar, në Shëtitoren e Plazhit do të kemi shtimin e hapësirave të gjelbërta, të cilat do të bëhen në shtator për arsye dhe të klimës, parku Vala që është në vetvete një park urban, në lagjen 18 dhe atje kemi pas shtim të hapësirave të gjelbërta dhe do të vazhdojmë me projekte si Parku Urban në Spitall, faza e dytë e Shëtitores së Plazhit dhe atje ku do të kemi mundësi në akse të ndryshme të rrugëve.

Për banjot publike ka patur një investim bashkia para 5 a 6 vjet para në zonën e plazhit dhe janë vandalizuar totalisht. Mendojmë që është një projekt, që duhet parë me kujdes dhe në aspektin e efikasitetit që ka. Nuk paraqet emergjencë në planet e bashkisë.

Invalidët, infrastruktura si dhe në transport dhe për banesat sociale, në përgjithësi në të gjitha projektet si ato që janë në zbatim dhe ato që janë zbatuar kanë patur prioritet për lëvizjen e personave me aftësi ndryshe duke bërë të mundur që të gjitha rrugët kryesore në qytet janë me rampa, janë të aksesueshme, rrugët kryesore në qytet, nuk po them që jemi të kënaqur me punën, duhet të vazhdojmë që të punojmë në këtë drejtim. Të gjitha shkollat e ndërtuar janë në zbatim të normave për fëmijët me aftësi ndryshe, duke bërë të mundur jo vetëm rampat por dhe vendosjen e ashensorëve për këtë qëllim. Ndërsa aplikimi i individëve për banesat sociale bëhet në bazë të legjislationit. Ligji përcakton se cilat janë shtresat që përfitojnë nga banesat sociale. Transporti nga ato kontrole që bëjmë ne invalidët e punës, të luftës, paraplegjik dhe tetraplegjik, të verbërit dhe shoqëruesit e tyre udhëtojnë pa paguar. Pastaj nëse keni ndonjë gjë specifike, pasi këto janë në vija të përgjithshme për shqetësimet që kishit.

Përsa i takon shërbimeve të kemp-it që bëhen në Tiranë. Ky shqetësim na ka ardh dhe ne, të cilin e kemi kërkuar dhe ne, por kjo është një gjë që varet nga qeveria qendrore dhe jo nga ne. Dhe peticioni juaj besoj do të jetë me vlerë nëqoftëse bëhet dhe arrim ta ndryshojmë këtë gjë.

Bonusi i qerasë është një kompetencë e qeverisë qendrore. Pra në bazë të aktit normativ ne çdo muaj kërkojmë fonde për bonusin e qerasë. Nuk kemi marrë, presim që të vi dhe t'ja kalojmë

menjëherë qytetarëve. Në rast se marrim përgjigje negative që nuk do ketë më, patjetër që do i bëjmë me dije, por do të shohim dhe mundësitë tona të bëjmë financimin e tij. Shumë faleminderit.

Edlira Shemsi : Faleminderit. Mundem

Ani Dyrmishi : Po. Keni 2 minuta.

Edlira Shemsi : Për çmimin e ujit që thashë që është mbi mesataren në Shqipëri, kjo është sipas informacioneve që unë kam parë. Nuk di të them mbi Patosin, por është shumë mbi mesataren. Dhe në lidhje me investimet që duhen bërë të kenë efikasitet ku të kemi 24 orë ujë. Por jemi në Durrës dhe të gjithë e dimë që s'kemi 24 orë ujë dhe vazhdon ende të jetë problematik dhe të mos vi fare. Kështu që unë shpresoj shumë që investimet të bëhen për të rritur efikasitetin, por pa humbur kohë pasi rëndohen dhe xhepat e qytetarëve.

Emiriana Sako : Kemi disa fshatra në njësitë administrative ku është investuar. Dhe investimi ujit s'bëhet dot në një vit pasi ka një kompleksitet investimi, financimi, realizimi i tij. Kemi zonën e Spitalës, zonën e Porto-Romanos, në njësitë administrative, Sukth, Katund i ri, të cilët në zona të caktuar jo të gjitha se ka një proces dinamik që vazhdon, janë me ujë 24 orë. Manza po, duke hequr një fshat, i cili ka ende probleme. Nga ana tjetër përsa i takon qytetit kemi marrë mbështetje nga Fondi Francez për Zhvillim për të realizuar investimin më të rëndësishëm që ka patur ndonjëherë qyteti i Durrësit në ujësjellës për furnizimin me ujë në 24 orë për pjesën e qytetit.

Edlira Shemsi : Unë besoj që ai aplikim të ketë filluar, unë pyetjet i bëra bazuar nga një informacion që kisha që dhe ata të informoheshin. Besoj që dhe aplikimi i këtyre taksave do të jenë më në shërbim për qytetarët.

Ani Dyrmishi : Dua të bëj një sqarim për gjithë këshilltarët. E kërkon fjalën z. Laçi, do ta shkel rregulloren e do ta jap. Por që të marrësh fjalën duhet të jesh i regjistruar. Por për herë tjetër kur bëhen pyetjet zj. Shemsi nuk ka replikë mbrapa. Bëhet pyetja, kryetarja përgjigjet dhe mbaron diskutimi këtu.
z. Laçi vazhdo.

Erzen Laçi : Z. Kryetar, faleminderit.

Duke qënë se unë jam në një zonë që jam dhe banorë dhe në Katund të ri nuk ka 24 orë ujë siç tha kryetarja, mund të verifikohet shumë lehtë.

Emiriana Sako : Nuk thashë që ka 24 orë, thashë ne jemi duke punuar.

Erzen Laçi : The 24 orë e po ta verifikojmë uji vjen në 11 të natës deri në orën 1- 2 dhe njerëzit strapacohen duke u zgju nga gjumi me nez ato pompa kush të kapi i pari me tërheq ujin. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.
Zonja Kasa.

Flutura Kasa : Përshëndetje.

Unë e tërheq pyetjen time se para mbledhjes pata një takim me punonjësit e bashkisë, kështu që e mora përgjigjen. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Në rregull, z. Myshketa.

Jonuz Myshketa : E nderuar zonja kryetare e bashkisë, i nderuar kryetar, të nderuar koleg!

Në rradhë të parë dua të shpreh mirnjohjen e të gjithë qytetarëve që na besuan mandatin e këshilltarit. Është përgjegjësi, privilegj e mbi të gjitha detyrim t'i përfaqësojmë duke respektuar maksimalisht ligjin e të jemi zëri i tyre në zgjidhjen dhe përmirësimin e problematikave të ndryshme që për hir të vërtetës janë të shumta.

Për këto kërkoj bashkëpunimin e secilit prej jush në këtë sallë, mirëkuptimin tuaj kundrejt bashkëqytetarëve pa asnjë dallim apo ngjyrim politik. Të mos harrojmë elementin kryesor që na bën bashkë këtu, natyrën dhe qënien njerezore që jemi dhe i përkasim. Ta respektojmë atë, mbrojmë atë.

Dua të ndalem në 2 çështje konkrete të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, që janë pasojë e njëra-tjetrës dhe që janë shqetësim parësor i qytetarëve të Durrësit, të kontaktuar personalisht, me telefonata të dhëna prej tyre.

Tërmeti i nëntorit të 2019-ës, ishte një fatkeqësi për Durrësin, duke mos harruar për asnjë moment humbjen e jetëve të 51 bashkëqytetarëve tanë, prishjen e banesave, bizneseve, traumat e shkaktuara, që akoma janë një plagë e hapur për të gjithë ne. U cek dhe nga zj.Shemsi pjesa e bonusit të qerasë, për të cilën kam një vëmendje të theksuar Ka mbi 5-6 muaj që banoret banesat e të cilëve janë të pajetueshme sipas kushteve optimale për shkak të dëmeve të pësuar nga tërmeti, që nuk përfitojnë nga bonusi i qirasë. Një e drejtë e tyre që u buron nga ligji .

Kjo mungesë e ndihmës ka krijuar një traumë tjetër për ta, për ta pa kaluar ende të parën ku fatkeqësisht, munda, djersa e sakrificat e një jete u bënë shkrumb e hi vetëm në pak sekonda. Kjo situatë është kthyer në një problem primar për ta, pasi në pamundësi pagese ka krijuar debata e konflikte verbale me qiradhënësit e banesave ku ata përkohësisht strehohen. Me të drejtë qiradhënësit pretendojnë kundërvlerën e akorduar për shërbimin e ofruar, ndërsa banorët për shkak të ndërprerjes së tij nuk kanë mundësi pagese. Ç'ka bën që disa prej tyre, pas daljes nga banesat e marra me qira, disa të tjerë në të shumtën e rasteve jane rikthyer në banesat e tyre ende të papërfunduara nga procesi i rindërtimit duke marrë përsipër risqet e një banese të papërfunduar dhe të paçertifikuar për kushtet e sigurisë së saj.

Pikërisht këtij fenomeni i referohem dhe konkretisht dhe për bllokun e pallateve ndodhur në lagjen 18 të Durrësit, në rrugën Horizonti, pra është një bllok pallatesh ku bashkëjetojnë 120 familje dhe është i papërfunduar. Këtu tregohet qartë (..tregon foto..) dhe materiale ndërtimi dhe inerte të lëna përgjys. Ka një shpjegim për to? Firma sipërmarrëse në raport me çfarë është

pyetur prej nesh dhe prej banorëve, thotë që punimet janë ndërprerë për shkak të mungesës së pagesës të kryer nga bashkia duke lënë të papërfunduara punimet dhe në fund qytetarët e pësojnë dhe shumica e tyre rikthehen në banesat e tyre për shkak se nuk kanë mundësi pagese. Gjykoj dhe besoj fort që duhet të merren masat urgjente për zgjidhjen e këtij problemi dhe një sqarim shterues me afate konkrete për qytetarët.
Faleminderit .

Emiriana Sako : Faleminderit për ngritjen e shqetësimit.

Realizimi në strukturat DS4 ka qënë ai më kompleksi, duke e krahasuar me punët e tjera që bën bashkia që nga infrastruktura rrugore, ndërtime shkollash, kopshte e të tjera me radhë apo në çfarëdo ndërhyrje sepse ndryshe është kur ndërhysh në një territor të lirë e ndryshe të ndërhym në një njësi private. Pengesa janë hasur në zbatimin e kontratave, të gjitha kontratat kanë nga një ose dy objekte që hasim problematika. Ka qytetarë që nuk duan të bëhet investimi, pra refuzojnë të hapin dyert e banesave të tyre, ka qytetarë që ndodhen jashtë dhe ne nuk kemi autoritet të futemi në shtëpitë e tyre, por do presim ta hapi dikush tjetër. Ka një raport kompleks, sepse firmës që të punoj i duhet që të shkëputet energjia elektrike dhe uji i pishëm dhe kjo është një marrëdhënie private midis subjektit, atij që ka apartamentin dhe OSHEE-së, pra do duhet të presim të gjitha këto hapa. Shpesh herë kemi bashkëpunuar dhe me policinë e shtetit apo dhe drejtorinë sociale për të folur me njerëzit dhe për t'i shpjeguar se çfarë ndodh dhe rëndësinë që ka ky program. Këto objekte janë drejt fundit. Dhe në fotot që ju tregoni pjesa kryesore e pallatit ka përfunduar është vetëm pjesa e katit përdhe që është duke u punuar. Parashikojmë të fillojmë punën javës që vjen në mënyrë që ta përfundojmë dhe investimin për atë pjesë që ka mbetur.

Për bonusin ktheva përgjigje pak më parë.

Jonuz Myshketa : Kam të drejtë të bëj një sqarim.

Ani Dyrmishi : Vetëm këtë radhë.

Jonuz Myshketa : I vetmi shqetësim është se shumë banorë për shkak të ndërprerjes së punimeve janë rikthyer në banesat e tyre. Kjo është e gjitha. Ato banorë kanë dal gjatë kohës që punimet janë kryer, janë rikthyer për shkak të mos pagesës për shtëpiat qeramarrëse dhe ky është i vetmi shqetësim i zgjidhjes sa më parë.

Emiriana Sako : Nuk kanë ardhur vonesa nga ana e bashkisë, ka problematika që unë përmenda. Firmat në bazë të situacioneve që sjellin ne bëjmë kërkesën në Ministrinë e Financave, në bazë buxhetit bëhet kalimi i financimit, kështu që procesi është dinamik.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Kuçi

Kontjana Kuçi : Me sa po shoh pjesa që është më kritike e qerave për familjet e pastreha nga tërmeti shoh që është shqetësimi i të gjithëve. Përgjigja erdhi, megjithëse gjatë fushatës elektorale kam dëgjuar që ka qënë premtim edhe grantet edhe bonuset. Kjo s'qeka kompetencë e

bashkisë, pritet nga qeveria. Gjithësesi e shoh që edhe nëpër portale dhe edhe nëpër sms gjatë kohës që ne biseduam këtu shqetësimi kryesor i qytetarëve është bonusi.

Pika 2-të që grupi i PL-së ka bërë është moskalimi i granteve 40 dhe 60 % për banesat individuale në njësitë administrative Ishëm, Manëz, Sukth, Katund i ri, Rrashbull edhe në Durrës.

Gjithashtu ne do të donim dhe një informacion në lidhje me kantierët, objektet e dëmtuara nga tërmetit të cilat janë ende të hapura dhe të papërfunduar dhe i ka kaluar afati kohor i lejeve.

Një pikë tjetër dhe më konkrete të cilën unë e kam tamam tamam në pallatin tim, lagjja 5, rruga Hysen Myshketa është që dhe në krahun e majtë dhe në krahun e djathtë të pallatit tim janë dy pallate të dëmtuara nga tërmeti, të cilat janë gërmadhë prej 4 vite. Kaq kisha. Faleminderit.

Emiriana Sako : Në fillim familja ka marrë 60 % e më pas kalon 40 %-shi . Ka familje që miratohen ende në këshill bashkiak, kështu procedura për to kalon në kalim për financim, kërkesë për financimin në KSHR, pra Komisioni e Shtetit për Rindërtimin dhe miratimin e buxhetit. Në qoftë se ke emra konkret të familjeve, të cilat nuk janë likujduar sepse më duket pak e përgjithshme dhe nuk mund të jap një përgjigje të saktë dhe specifike, nëse ke emra konkret, që nuk janë likujduar me thuaj të interesohem në cilën fazë ndodhet dhe të jap një informacion. Është një proces që ka qënë dinamik ka patur familje që kanë dashur të bëjnë një ndryshim në projektin model ose kanë dashur ta kenë shpinë patjetër aty ku e kanë pasur, kanë pasur opsionin e grantit, ka kaluar nga programi transferim nga grantet 60 e 40 janë likujduar dhe në bazë të kushteve që kanë zbatuar. Ka ndodh që kanë marrë 60 % -shin e nuk kanë zbatuar projektin, kanë dal tërësisht nga leja dhe bëhen objekt i një kontrolli tjetër më tej apo IMT-ja që është në varësi të bashkisë së Durrësit që kontrollon zbatimin e tyre, nuk vazhdon likujdimin e grantit në rast se sheh shkelje të lejes. Kjo është ideja, po nëse ke emra konkret të interesohem e të jap përgjigje.

Përmenda pak më parë kontratat DS4 janë në punë akoma. 28 objekte kanë përfunduar, 20 pallate dhe pjesa tjetër banesa individuale. Lotet janë të ndara një pjesë banesa dhe një pjesë banesa individuale të cilat zhvillojnë punën në terren. Siç e përmenda pallatet kanë një kompleksitet pak më të lartë. Jemi çdo ditë në terren për të ndjekur punën në këto objekte që të mbarojmë sa më parë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit kryetare, faleminderit të gjithëve. Mbledhjen e radhës.....

Dritan Burgija : Në emër të grupit mund ta mbyll me 2, 3 fjali.

Ani Dyrmishi : Po.

Dritan Burgija : Atëherë në momentin që votoheshin pikat e rendit të ditës dikush këtu në sallë tha “ kaq ju kanë dhënë, kaq vota keni”. Po është e vërtetë kaq vota kemi përballë makinerisë shtetërore të blerjes së votës kaq vota, ky do ishte rezultati. Po të jeni të sigurtë se do jemi këtu përballë jush, siç po e tregojmë dhe këtu sot, kaq pak sa jemi. Nuk e di ndoshta kryetarja vihet në vështirësi.

Emiriana Sako : Jo unë kam shtrirë dorën e bashkëpunimit.

Dritan Burgija : Natyrisht dhe neve gjithashtu. Të jeni të sigurtë se do jemi në shërbim të qytetarëve të Durrësit, për të bërë transparencë këtu, për të informuar. Nuk do ta keni të lehtë siç e kishit 4 vite të shkuara, ku për shkak se bletë kryetarin tonë arritët që të kishit një këshill monist. E treguat bashkëpunimin dhe ditën e parë të këtij këshilli, edhe sot me votën. Nëse do të kishim dhe ish kolegët tonë pro, pikat që ne refuzuam nuk do të kishin kaluar. Shumë kush nga ju mund ta konsideroj si triumf këtë për sa fola më sipër. Edhe këto që nuk e kanë kuptuar ende se çfarë dëmi i shkaktojnë apo i është bërë këtij vëndi.

Hekuran Markola : Ti s'ke parti, je pa parti.

Ani Dyrmishi : Z. Markola, ju lutem.

Dritan Burgija : U pa dhe dje në komision, për çështje niveli nuk do të replikoj fare. E mbyll fare. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Z.Xhelili.

Rolant Xhelilaj : E para për procedurë. Pas përgjigjes së kryetares të bashkisë nuk ka komente. Siç gjithë të tjerët dhe z. Burgija të kish kërkuar fjalën.

Megjithatë votat i vendos elektorati, i vendosin qytetarët. Qytetarët vlerësojnë, sa vlerë keni aq vota ju japin. Sa vlerë kemi aq vota na japin. Dhe më pëlqen fakti që thoni se ne bashkë do të ndihmojmë qytetin, për pjesën tjetër pastaj të jesh i bindur se është më mirë t'ju kemi këtu për të bërë punë të mira dhe është më keq kur ju jeni jashtë këshillit, kuvendit dhe tjera me radhë. Është çështje që kalon dhe kompetencat që keni ju, pasi dhe Hekurani nxitohet i çik, por dhe duhet të sqaroni pozicionet politike për atë që përfaqësoni, por mund të jeni dhe më të kujdesshëm në atë që thoni. Ne të gjithë këtu jemi me votën e qytetarëve durrsak, asnjë s'ka ardh këtu me dëshirën e tij. Jeni pak jeni shumë, pak rëndësi ka, të gjithë bashkë të bëjmë më të mirën për Durrësin, të jemi pastaj të nderuar ne qytet e ku shkojmë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Flutura Kasa: Kryetar.

Ani Dyrmishi : Jo Flutura s'do e marrësh fjalën.

Flutura Kasa: Sekretarja t'i shpërndaj rregulloren me email .

Dritan Burgija : S'ka nevojë me e shpërnda se e kemi rregulloren.

Ani Dyrmishi : Sipas rregullores, pas përgjigjes së kryetares të pyetjeve që bëhen nga këshilltarët, kryetarja e merr fjalën e fundit, s'ka më replikë. E shkela me Erzenin e shkela me Ju e lamë ta vazhdonin kështu. Mledhjen e ardhshme nuk ka më kështu, procedurën e shpjegova të jemi të qartë të gjithë.

Arjeta Keçi : Gjatë diskutimeve mund të diskutoj kushdo.

Ani Dyrmishi : Po, por duhet të regjistrohesh.

Arjeta Keçi : Po mund të më vi pyetja në moment.

Ani Dyrmishi : Atëherë përgjigjen s'mund ta marrësh në moment se ndoshta kërkon më shumë informacion dhe përgjigjen e merr mbledhjen e ardhshme. Gjithsesi kjo është procedura.

Përsa i takon mbledhjes së ardhshme kemi menduar ta mbajmë në muajin shtator, pasi në muajin gusht shumë nga këshilltarët janë me angazhime apo pushime. Kështu që për mbledhjen e radhës do ju njoftoj Sekretaria e Këshillit.

Faleminderit të gjithëve. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 30 (tridhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ALNEIDA RROSHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Grupit Partisë Demokratike :

JONUZ MYSHKETA